

VENDIM
Nr. 96, datë 27.2.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI I RRUGËS QË LIDH RRUGËN ‘DON BOSKO’ ME RRUGËN ‘EGNATIA’,
TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën ‘Don Bosko’ me rrugën ‘Egnatia’, Tiranë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me vlerë të përgjithshme prej 3 496 528 (tre milionë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit “truall”, prej 3 496 528 (tre milionë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekësh, të përballohet nga fondet e Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët që shpronësohen, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Bashkisë Tiranë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**Lista emërore e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i
projektit “Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën ‘Don Bosko’ me rrugën ‘Egnatia’, Tiranë”**

Shënim: çmimet për truallin janë marrë në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016

Nr.	Emër /Mbiemër	Lloji i pasurisë	Z. K.	Nr. i Pasurisë	Sip. totale truall (m ²)	Sip. trualli i prekur (m ²)	Çmimi truall lekë/m ²	Sip. Obj. e prekur (m ²)	Çmimi obj. lekë/m ²	Vlera në lekë	Shënime në kartelë/pjesët takuese
1	Vladimir Pjetërgjokaj	Truall	8310	6/922	399.1	19	31219			593161	
2	Skënder Pahumi	Truall	8310	6/923	207.9	17	31219			530723	
3	Mirjana Pahumi Besmir Pahumi Nertila Pahumi	Truall	8310	6/924	216.9	4	31219			124876	Mirjana Ahmet Pahuni 1/3 B Besmir Avni Pahuni 1/3 BNertila Avni Pahuni 1/3 B
4	Lulzim Kalbaj	Truall	8310	6/624	288	4	31219			124876	

5	Blerim Feim Shqiponja Feim Sherif Shqiponja	Truall	8310	6/620	248.1	18	31219			561942	Blerim Feim Shqiponja 1/2 B Feim Sherif Shqiponja 1/2 B Përshkrim I veçantë: Godinë banimi 3 kate B
6	Niko Bengu Gëzim Sherif Shqiponja Sali Ismail Zaimi	Truall	8310	6/927	266.3	21	31219			655599	Niko Shefki Bengu 1/3 B Gëzim Sherif Shqiponja 1/3 B Sali Ismail Zaimi 1/3 B
7	Viktor Marku Zef Qarraj	Truall	8310	6/928	262	22	31219			686818	Viktor Gjon Marku 1/2 B Zef Gjon Qarraj 1/2 B
8	Luk Kalaj Katrine Kalaj Tom Kalaj Gasper Kalaj	Truall	8310	6/929	145.3	7	31219			218533	Luk Ded Kalaj 1/4 B Katrine Gjergj Kalaj 1/4 B Tom Ded Kalaj 1/4 B Gasper Ded Kalaj 1/4 B
Vlera totale Paraprake						112				3496528	

